



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONI RREGULLATOR

Data: 31 Mars 2021

Nr: 12

V E N D I M

P Ë R

**SHPLLJEN E MOSKOMPETENCËS SË KOMISIONIT RREGULLATOR PËR
SHQYRTIMIN E PROJEKTVENDIMIT PËR MIRATIMIN E PËRMBAJTJES SË FLETËVE
TË VOTIMIT PËR ZGJEDHJET PËR KUVENDIN E SHQIPËRISË
TË DATËS 25 PRILL 2021**

Komisioni Rregullator, në mbledhjen e tij të datës 31.03.2021, me pjesëmarrjen e:

Ilirjana	NANO -	Kryetare
Arens	ÇELA -	Anëtar
Dritan	ÇAKA -	Anëtar
Helga	VUKAJ -	Anëtare
Muharrem	ÇAKAJ -	Anëtar

Shqyrtoi çështjen me:

OBJEKT: Për shpalljen e moskompetencës së Komisionit Rregullator për shqyrtimin e projektvendimit “Për miratimin e përmbajtjes së fletëve të votimit për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 prill 2021.

BAZA LIGJORE: Nenet 20, pikat 1 e 2, 98 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.



Komisioni Rregullator, pasi u njoh me materialet e paraqitura dhe diskutimet në mbledhjen publike,

VËREN

Presidenti i Republikës, në mbështetje të neneve 65, pikat 1 dhe 2, 92 shkronja “gj”, e 93 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe të neneve 8, 9, pikat 1 dhe 4, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar, me Dekretin nr. 11700, datë 06.09.2020, ka caktuar datën 25 Prill 2021 për zhvillimin e zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë.

Në përfundim të afatit për regjistrimin e listave shumëpartisore në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, janë regjistruar gjithsej dy koalicione zgjedhore, koalicioni me shkronja nistore (PD-AN) dhe koalicioni me shkronja nistore (ABEOK) 10 (dhjetë) parti politike dhe 5 (pesë) Kandidatë të Pavarur që garojnë më vete për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 prill 2021.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve miraton fletët e votimit sipas specifikimeve të nenit 98 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

Referuar nenit 19, pika 1, shkronja “c” të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka vënë në lëvizje Komisionin Rregullator duke paraqitur për shqyrtim projektvendimin “Për miratimin e përmbajtjes së fletëve të votimit për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 prill 2021”.

Neni 20 pika 1, e ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, përcakton në mënyrë shtetërore kompetencat e Komisionit Rregullator për shqyrtimin dhe miratimin e projektakteve me karakter normativ dhe pika 2 përcakton në mënyrë të qartë llojet e projektvendimeve që shqyrtohen dhe miratohen nga ky Komision.

Neni 98, pika 4, e ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nuk ia njeh në mënyrë të shprehur kompetencën për miratimin e fletës së votimit Komisionit Rregullator, por e lë në diskrecion të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Vetë legjislatori, në pikën 1 të nenit 98, ia ka njohur kompetencën Komisionit Rregullator për të miratuar elementet e sigurisë së fletëve të votimit. Për këtë autorizim ligjor, Komisioni Rregullator ka disponuar me vendimin nr. 6 datë 26 shkurt 2021 “Për miratimin e specifikimeve teknike të fletës së votimit për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 prill 2021.

Nëse vullneti i legjislatorit do të kishte qenë që konfigurimi i fletëve të votimit duhet të miratohej nga Komisioni Rregullator në pikën 4 të nenit 98 do t’ia kishte njohur këtë kompetencë këtij Komisioni.



PËR KËTO ARSYE:

Në mbështetje të neneve 20, pikat 1 e 2, e 98, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar .

V E N D O S I:

1. Të shpall moskompetencën e Komisionit Rregullator për shqyrtimin e projektvendimit “Për miratimin e përmbajtjes së fletëve të votimit për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 prill 2021”.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 5 (pesë) ditëve në Kolegjin Zgjedhor pranë Gjykatës Administrative të Apelit, Tiranë.

Ilirjana NANO - Kryetare

Arens ÇELA - Anëtar

Dritan ÇAKA - Anëtar

Helga VUKAJ - Anëtare

Muharrem ÇAKAJ - Anëtar

